

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

05.12.2020

Ora 11:00

RENDI I DITËS


Projektakti “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilijan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj**
- **Parti Politike PD, LSI**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Të nderuar kolegë përshëndetje, fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Verifikojmë pjesëmarrjen. Janë të pranishëm katër anëtarët e Komisionit Rregullator, zonja Vukaj do të na bashkohet shumë shpejt për shkak të një problemi teknik. Është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, zoti Celibashi. Janë të pranishëm përfaqësues të partive politike parlamentare. Mediat e ndjekin live në kanalën tonë në YouTube mbledhjen. Nëse problemi teknik me

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

zonjën Vukaj do të zgjidhet shpejt, atëherë fillojmë mbledhjen. Mbledhja e sotme ka tre pika në rendin e ditës.

Së pari, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Pika e dytë e rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”.

Pika e tretë e rendit të ditës: Një seancë dëgjimore me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, me kërkesë të Komisionit Rregullator është thirrur kjo seancë, për t’i drejtuar përfaqësuesit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile disa pyetje lidhur me proceset shumë të rëndësishme që janë duke u zhvilluar. Gjithashtu dhe komunikimin që KQZ-ja ka mbajtur deri tani me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile lidhur me numërin e përgjithshëm të shtetasve, lidhur me numërin e shtetasve në çdo qark. Të dhëna këto që do të duhen për të llogaritur mandatet për Kuvendin për çdo zonë zgjedhore, ne vlerësojmë që në mbledhjen e ardhshme do të miratojmë me aktin përkatës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Sipas Kodit Zgjedhor, ky projektakt është përgatitur nga administrata e KQZ-së dhe është dërguar për shqyrtim dhe miratim në Komisionin Rregullator. Do t’i lutesha Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi për të prezantuar projektaktin dhe relacionin përmbledhës të tij.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.I.Celibashi: Faleminderit, atëherë fillimisht duhet të theksoj që ky akt vjen në përmbushje të detyrimeve që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka për përgatitjen e procesit zgjedhor. Ky akt është në kompetencë miratuese të Rregullatorit. Mendojmë që kemi reflektuar në këtë akt të gjitha përcaktimet e Kodit Zgjedhor në lidhje me ngritjen e qendrave të votimit, numërin e zgjedhësve në qendrat e votimit, kriteret e përgatitjes së hartës së zonës së qendrës së votimit. Mendojmë që të gjitha këto përcaktime të Kodit Zgjedhor reflektohen të detajuara mirë në këtë projektakt dhe mendojmë që do t'i shërbejë si organeve të qeverisjes vendore, po ashtu dhe komisioneve të qendrave të votimit, por dhe zgjedhësve në kuptim të dijenisë së tyre mbi vendin e votimit. Qëllimi i këtij projektakti është që këto rregulla të përcaktohen qartë dhe janë rregulla që do të ndiqen nga organet e qeverisjes vendore për caktimin e zonave të vendndodhjes së qendrave të votimit në përthutje me parashikimet e nenit 46, paragrafi 1 dhe 2, nenit 50, 52, 62, nenit 93, neni 108 paragrafi 7 dhe neni 109, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor. Gjithashtu ky projektakt ka përcaktuar dhe rregulla që lidhen me njoftimin në lidhje me të dhënat që kanë të bëjnë me qendrën e votimit nëpërmjet zgjedhësve dhe njoftimin e tyre përcaktimin e vendndodhjes, adresave e të tjera karakteristika të këtij procesi. Mendojmë që ky projektakt i ka parashikuar në mënyrë të detajuar të gjitha ato aspekte që kanë të bëjnë me vendndodhjen e qendrës së votimit dhe përcaktimin e kriterëve për organizimin e hartave të qendrës së votimit. Më shumë nuk po zgjatem pasi relacioni është bërë i ditur si për anëtarët e Rregullatorit, po ashtu dhe për përfaqësuesit e partive politike. Gjithashtu është konsultuar dhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi, sikundër ju sapo e thatë, ky projektakt është konsultuar paraprakisht dhe me përfaqësues të partive politike parlamentare

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

si dhe me organizata të shoqërisë civile. Unë po çel diskutimin në parim lidhur me projektudhëzimin. Së pari u drejtohem kolegëve anëtarë të Komisionit Rregullator në se kanë diçka për të diskutuar në parim dhe më tej përfaqësuesve të partive politike parlamentare. Edhe pse ata më herët e kanë marrë aktin dhe në çdo rast kur kanë mendime, vlerësime, sugjerime i dërgojnë paraprakisht. Të nderuar kolegë, keni diçka për të cilën dëshironi të merrni fjalën? Përfaqësuesit e partive politike parlamentare? Me sa shoh unë nuk ka diskutime në parim. Unë do të ftoj anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë në parim projektudhëzimin “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”. Zonja Vukaj është prezent në mbledhje.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet në parim projektudhëzimi.

Fillojmë diskutimin nen për nen. Sipas rregullores për organizimin e punës së Komisionit Rregullator në diskutimin nen për nen më së pari i japim fjalën përfaqësuesve të partive politike parlamentare. Projektudhëzimi ka 13 nene. Ndërkohë ka dhe kritere teknike për përgatitjen e hartave të njësisë të qeverisjes vendore për zgjedhjet. Ka gjithashtu bashkëlidhur udhëzimit dhe hartën e qendrës së votimit dhe formularë tip me të dhënat për qendrat e votimit. Do t’u pyes paraprakisht, kemi përfaqësues të disa subjekteve, të disa partive politike me sa shoh të Partisë Demokratike dhe të Lëvizjes Socialiste për Integrim. Nëse keni paraprakisht për aktin ndonjë koment, ose diskutim për ndonjë nen të caktuar në mënyrë që të mos ju pyes nen për nen nëse keni ndonjë sugjerim konkret.

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.I.Kaso, përfaqësues i Partisë Demokratike: Faleminderit zonja Kryetare, një koment të vogël besoj se është i zgjidhshëm. Lidhur me planvendosjen që shoqëron aktin, për sa i takon vendosjes jo vetëm të komisionerëve dhe dhomave të fshehta e kutive të votimit, duhet parashikuar edhe pozicioni në të cilën do të vendosen kamerat brenda qendrave të votimit. Detyrim ligjor ky që rrjedh nga Kodi Zgjedhor me ndryshimet e fundit. Besoj se është një harresë, po mirë është që të përcaktohet. Sigurisht nuk ka për të qenë i njejtë për të gjitha qendrat e votimit, por të përcaktohet në një pikë si parim që diku do të vendoset kamera që do të regjistrojë, po larg nga pjesa e dhomës së fshehtë ku zgjedhësi do të bëjë zgjedhjen e tij për preferencën. Pra, duke mos i dhënë asnjë mundësi kameras që të ndikojë qoftë dhe psikologjikisht mbi zgjedhjen e lirë të shtetasve që do të bëjnë në dhomat e fshehta, faleminderit.

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Kaso, nga ana e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim ka ndonjë propozim konkret?

Z.A.Kaziu, përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim: Po e nderuar zonja Kryetare, jam dakord me sa tha zoti Kaso. Është një parashikim ligjor i Kodit Zgjedhor në nenin 22 të tij dhe si i tillë duhet të pasqyrohet në çdo qendër votimi. Po ashtu kam dhe një shqetësim tjetër për sa i përket pjesës së skemës se ku, se si do të hyjë zgjedhësi. Se ku do të votojë, se çfarë hapash konkretë do të ndërmarren të themi. Këtu administrata e KQZ-së ka listuar katër pika si dalje kryesore. Fillimisht kur shkon zgjedhësi, verifikimi për timbrimin fillestar. Në pikën 2 do të doja të shtohet dhe paisja elektronike e identifikimit në bazë të rregullores së miratuar muajin e shkuar nga ana e Rregullatorit. Pra si hap i dytë të ishte kjo paisje elektronike e identifikimit, ose e ashtuquajtura PEI. Nuk e di a isha i qartë?!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Kazia, në fakt nuk e di keni një skemë të pak ditëve më parë se skema e qendrës së votimit është ripunuar dhe në skemën më të fundit është parashikuar sistemi i identifikimit elektronik të votuesit. Procesi i verifikimit elektronik të votuesit është përfshirë në skemë. Viojmë me diskutimin nen për nen.

Neni 1. Qëllimi dhe objekti.

Kemi ndonjë propozim konkret? Nuk po i lexoj nen për nen se materialet i kemi prej disa ditësh në duar të gjithë. Do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullator të votonim nenin 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Atëherë unë nuk po lexoj gjithshka Komisioneri parashtroi. Kemi tre pika të projektvendimit që Komisioni Rregullator do të miratojë.

Neni 2. Janë përkufizimet lidhur me atë çfarë përfaqëson qendra e votimit, zona e qendrës së votimit, numri i zgjedhësve për çdo qendër votimi, harta për çdo qendër votimi. Kemi ndonjë koment, sugjerim, propozim konkret? Kalojmë në votim të nenit 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 3. Kriteret për caktimin dhe ngritjen e qendrave të votimit.

Propozim konkret për ndonjë ndryshim? Nuk ka! E kalojmë në votim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Kush është dakord me nenin 3?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 4. Bashkimi i qendrave të votimit.

Është parashikim i Kodit Zgjedhor për rastet kur ka më pak se 300 zgjedhës. Cila është procedura që ndiqet. Është transfuzuar edhe në këtë nen të projektudhëzimit. Kemi ndonjë propozim konkret? Kalojmë në votim nenin 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 5. Kriteret teknike dhe paisjet e qendrës së votimit.

Nuk e di nëse është vendi këtu për të diskutuar ato që propozoi zoti Kaso dhe zoti Kazia që unë do t'u bashkohesha, por është vendi më tej për atë propozim, është tek skema.

Znj.H.Vukaj: Në qoftë se dispozita e pranon mundet që pjesën e propozimit të zotit Kaso meqenëse ka merak qendrën e votimit. Nëse kjo dispozitë realisht e pranon, atëherë propozoj që të ndalemi e ta rishikojmë dispozitën. Në të kundërt të vijojmë e të gjejmë dispozitën respektive për të implementuar çfarë propozoi zoti Kazia dhe zoti Kaso.

Z.D.Çaka: Këtu mund të ketë një ndarje, sepse tek pika 2 thotë që “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:...”. Nuk besoj që paisja me

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

kamera e qendrës së votimit nuk është një detyrim që i ngarkohet kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes.

Z.M.Çakaj: Unë mendoj se neni 5 “Kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit” është neni i duhur ku ne mund të vendosim detyrimin e parashikuar nga Kodi Zgjedhor neni 22/2 për paisjen me kamera. Përtej faktit se në kompetencë të kujt është instalimi apo vendosja e kamerave. Unë e gjej me vend propozimin edhe të përfaqësuesve të partive politike, por dhe të koleges Vukaj që këtu të vendosim mundësinë e futjes së sistemit të video-monitorimit. Pra, kamera e qendrës së votimit vendoset në mënyrë të tillë që të garantojë parimin e fshehtësisë së votës.

Znj.I.Nano: Unë kam një propozim konkret, ta shtojmë si pikë të tretë të nenit 5 “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr masa për paisjen me kamera të qendrave të votimit, të cilat vendosen në mënyrë të tillë që garantojnë fshehtësinë e votës dhe nënkuptohet që kamera nuk do të ketë pamje nga dhoma e fshehtë. Nuk e di nëse i plotëson kriteret ky propozim. Të jetë një pikë e tretë dhe kënaq, le të themi dhe propozimet e përfaqësuesve të partive politike. Pra, të jetë pika 3.

Znj.H.Vukaj: E rëndësishme është të garantojë se për kënaqësi pastaj...

Znj.I.Nano: Pra, tek “Kriteret teknike dhe pajisjet e qendrës së votimit” pika 2 ka të bëjë me detyrimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, që të marrë masa për:

pajisjen e QV-së me tavolina, karrige apo pajisje të tjera, krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara... pikë e tretë të jetë “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr masa për paisjen me kamera të qendrave të votimit..”, po të doni

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

vendosim dhe referencën ligjore sipas nenit 22, pika 2 të Kodit Zgjedhor. “..kamerat duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të garantojnë fshehtësinë e votës”

Z.M.Çakaj: Më lejoni të riformuloj një propozim më konkret në qoftë se biem dakord? Së pari jam dakord me propozimin tuaj zonja Nano që të jetë një pikë e tretë. Së dyti, propozimi im konkret lidhur me mundësimin e futjes së saj, duke ju referuar edhe teknikës legjislative të mënyrës se si është ndërtuar neni 5. Pika e parë mjedisi i qendrës së votimit. Pika e dytë Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, merr masa për:, dhe pika e tretë të jetë “Në mjediset e qendrës së votimit duhet të instalohet sistemi i video-monitorimit në mënyrë të tillë që të garantojë parimin e fshehtësisë së votës. Besoj se duke e vendosur si nen në mënyrë që vendoset parimi në mënyrë që nesër pasnesër në momentin e futjes së tij e kemi si parashikim ligjor dhe i referohemi. Si mendoni kolegë?

Znj.I.Nano: Do ta vendosim KQZ-ja merr masa?

Z.M.Çakaj: KQZ-ja e ka tagrin nga Kodi Zgjedhor. Në rastin konkret po flasim për kriteret teknike dhe paisjet e qendrës së votimit. Jemi përsëri tek mjedisi i qendrës së votimit. Gjithësesi si ta gjykoni. Propozimi im ky është.

Znj.H.Vukaj: Mua mu duk propozim korrekt.

Znj.I.Nano: Është në vijim të pikës 2, ose ajo që thatë ju më mirë të vendosim pikën 2 këtë që është detyrim i KQZ-së dhe pikë 3 atë që është detyrë e kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.A.Kaziu, përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim: Do të kishte më kuptim dhe sipas mendimit tim, meqenëse dhe pika e parë flet për mjedisin e qendrës së votimit dhe vjen në vijimësi të pikës së parë do të ishte kjo që sapo propozoi zoti Çakaj. Pika e dytë e aktit të kalonte pikë e tretë.

Znj.H.Vukaj: Le të dalë përgjegjësia e pushtetit vendor.

Znj.I.Nano: Propozimi është ky si pikë e dytë të vendoset detyrimi i KQZ-së sipas nenit 22, pika 2 të Kodit Zgjedhor dhe si pikë e tretë kjo që është detyrimet e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. E votojmë këtë propozim?

Z.M.Çakaj: Ta riformuloj dhe njëherë propozimin?

Znj.I.Nano: Besoj se jemi të qartë, thjesht edhe në vendosje, pika 2..

Znj.H.Vukaj: Në parim jemi të qartë, por për zbardhje duhet dhe njëherë propozimi.

Znj.I.Nano: Atëherë e votojmë propozimin e zotit Çakaj?

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 5 me ndryshimet e prpzuara dhe diskutuara nga ana jonë!

Neni 6. Harta e njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Ka ndonjë propozim konkret? Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Mbase jo një propozim, por mbase IT e KQZ-së mund të na ndihmojë. Në pikën 2 të këtij neni thuhet “Harta e njësisë përkatëse për zgjedhjet përgatitet në formë dixhitale. Harta në format dixhital shoqërohet edhe me hartë të printuar në format A1”. Ndërkohë në Lidhjen 2 ku janë kriteret teknike, në pikën a thuhet që “hartat do të printohen në format A 1” dhe në pikën b thuhet “hartat do të printohen në formatin A 0”. Duke qenë se këtu është formuluar A 1, ndërkohë këtu kemi dy formate të ndryshme... nuk e di nga pikëpamja teknike me aq sa unë kam njohuri formatet nuk janë të njëjta. Mbase mos duhet të rregullohet pika 2 ku të thuhet “hartat të jetë e printuar në formatin jo më të vogël se A 1 dhe t’i përfshijë të dyja? Kjo është dhe pak çështje teknike dhe mendoj se IT e KQZ-së mund të na japë një përgjigje më të saktë për këtë pjesë. Në qoftë se do të themi në akt formatin A 1 do të përjashtojmë A 0 tek lidhja tjetër.

Z.I.Celibashi: Kjo është një çështje që në aspektin teknik pastaj praktik është një çështje që mund të ndryshojë sepse është dhe çështje e aspektit se si printohen në këto dokumentet e ndryshme zgjedhore dhe të formateve. Ndoshta ai propozimi që dhatë ju që ta përfshijë atë i lë zgjedhje pastaj administratës së KQZ-së që rast pas rasti ta përshtasë atë. Mendoj që do të ishte më mirë ai opsioni i përfshirjes, i kufizimit nga lart.

Znj.I.Nano: Me hartë të printuar në format jo më të vogël se A 1. Jemi dakord me propozimin e zotit Çaka? Ta votojmë nenin 6 me këto ndryshime të propozuara?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merița DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Kundër: S'ka

Miratohet neni 6!

Neni 7 Informacioni për zgjedhësit me aftësi të kufizuara.

Kemi ndonjë propozim konkret për këtë nen, ndonjë shtesë apo ndryshim? E votojmë nenin 7?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 7!

Neni 8 Shpallja dhe njoftimi i vendndodhjes së qendrave të votimit.

Kemi ndonjë diskutim? E votojmë nenin 8?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 8!

Neni 9 Ndryshimi i vendndodhjes së qendrës së votimit nga KQZ.

Edhe ky nen në fakt është i parashikuar në Kodin Zgjedhor, qoftë dhe afati në kufi të të cilit mund të ndryshojë vendndodhja e qendrës së votimit. Ka ndonjë propozim konkret? E votojmë nenin 9?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 9!

Neni 10 Dërgimi i listës së zgjedhësve.

Po zoti Çaka!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.D.Çaka: Mendoj se aty ku thuhet që “Dërgimi i listës së zgjedhësve” të bëjmë një plotësim duke qenë se nuk është vetëm “Dërgimi i listës së zgjedhësve” por dhe i të dhënave për qv-të, duke parë dhe vazhdimin e pikës 1 e më tej. Mendoj që titulli i nenit 10 të riformulohet “Dërgimi i të dhënave për qv-të dhe i listës së zgjedhësve”. Pra të shtohet togfjalëshi “të dhënat e qv-ve” para listës së zgjedhësve, duke qenë se ...

Znj.I.Nano: Në fakt keni të drejtë në pikën 1. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore dërgon ...

Z.D.Çaka: Numrin e çdo qv-je.., mendoj “dërgimi i të dhënave për qv-të dhe i listës së zgjedhësve”.

Znj.I.Nano: Ka ndonjë propozim tjetër? Po zoti Çakaj!

Z.M.Çakaj: Sigurisht që jam dakord me propozimin e zotit Çaka, pra të riformulohet titulli i nenit 10 “Dërgimi i listës së zgjedhësve dhe të dhënave për çdo qv”. Por duke qenë se lista e zgjedhësve siç kemi dakordësuar dhe siç duket do t’i dërgohet PEI-it, unë personalisht do të doja ta shtonim dhe këtë në nenin 10.

Znj.H.Vukaj: Në qoftë se kjo është dispozita dhe dispozitat në vijim nuk pranojnë ndërhyrje, unë mendoj se këtu duhet të futet kjo pjesë.

Z.M.Çakaj: Sepse siç e dimë dhe nga organizimi i qendrës së votimit, por dhe nga proceset që kemi nisur paraprakisht, lista e zgjedhësve tashmë do të jetë në format elektronik dhe do ta disponojë PEI. Kështu që besoj se ky është neni, parashikimi

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KOZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

ligjor përkatës se ku mund ta implementojmë këtë. Pra, që t'i paraprijmë akteve të tjera.

Znj.I.Nano: Ju lutem ta rilexojmë nenin që të vlerësojmë nëse ka vend për këtë diskutim që jemi duke bërë. Personalisht dhe unë jam dakord me propozimin e zotit Çaka për ndryshimin e titullit për shkak se bëhet fjalë edhe për të dhëna të tjera jo vetëm për listën e zgjedhësve. Po e lexoj dhe njëherë paragrafin 1 të nenit 10. “Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, menjëherë pas miratimit të listës së zgjedhësve, por jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, dërgon në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës, numrin e çdo QV-je, vendndodhjen e tyre, numrin përkatës të zgjedhësve në listën e zgjedhësve, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, në letër dhe në formë elektronike”. A ka vend në pikën 1 të shtojmë ç’ka propozoni ju zoti Çakaj?

Znj.H.Vukaj: Ndoshta s’ka vend në pikën 1 por mund të shtojmë një pikë tjetër.

Znj.I.Nano: Ja t'i marrim me rradhë që të vlerësojmë se ku mund të bëjmë ndërhyrje. Përderisa këtu veç të dhënave të tjera kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, dërgon listën e zgjedhësve, në format në letër dhe në formë elektronike. Të paktën në pikën 1, unë nuk shoh një vend ku të përfshijmë PEI-in.

Z.M.Çakaj: Atëherë zonja Nano, më lejoni të sqaroj diçka. Mënyra se si është konceptuar ky projektakt normativ është njësoj sipas zgjedhjeve të mëparëshme. Pra, mënyrës së organizimit të zgjedhjeve të mëparëshme ku lista e zgjedhësve dhe çdo e dhënë tjetër, administrohej nga KZAZ-ja, e cila më pas në bazë të Kodit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Zgjedhor, ia drejtonte çdo qendre votimi. Në rastin konkret siç kemi rënë të gjithë dakord, siç kanë rënë dakord dhe forcat politike, po ndryshon procesi i menaxhimit dhe administrimit të listës së zgjedhësve. Kështu që unë mendoj që për t'i paraprirë nesër, pasnesër një procesi identifikimi biometrik, këtu duhet të ketë një parashikim që lista e zgjedhësve të aksesohet edhe në formatin elektronik e përshtatshme për PEI-in. Pra, ky është neni përkatës ku mund ta fusim, sepse siç e dimë të gjithë po krijohet një proces i ri, siç kemi marrë përsipër të gjithë që ta kryejmë këtë proces.

Znj.H.Vukaj: Mbi bazën e ndryshimeve të reja dhe mbi bazën e konceptimit të ri të zhvillimit të procesit. Pra, dikur nuk kishim një PEI...

Z.M.Çakaj: Do ishte mirë të merrnim mendim dhe nga propozuesi i këtij akti, nga Komisioneri nëse e sheh të arësyeshem propozimin dhe në kuadër të gjithë procesit që ka nisur.

Z.I.Celibashi: Nëse më lejohët?!

Znj.I.Nano: Po ju dëgjojmë zoti Celibashi!

Z.I.Celibashi: Unë mendoj se është rasti dhe në fakt tek ky nen do të ishte i përshtatshëm nga pikëpamja e organizimit të aktit që të vendosej ajo ç'ka propozoi zoti Çakaj. Ne tashmë e dimë dhe jemi në procesin e futjes së projektit të identifikimit biometrik të votuesve. Ndoshta do të duhet ta përcaktojmë shumë qartë dhe në mënyrë ekspicite këtë moment. Ai formulim i shkruar ndoshta më mirë, në mënyrë më precize mund të përfshihej në nenin 10. Me pak fjalë ne do të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

duhet ta themi qartë në fakt. Mund t'i referohemi PEI-it direkt, sepse ai është një akt që është në fuqi tani. Nuk është se flasim për diçka që nuk është e sqaruar, ose nuk është e ditur. Është e ditur dhe e sqaruar se çfarë përfaqëson PEI, opinionimi im është që të jetë e përcaktuar qartë, faleminderit.


Znj.I.Nano: Zoti Çakaj, mund të na jepni propozimin tuaj konkret në mënyrë që ta votojmë? Pra kemi tre pika, tre paragrafë të nenit 10 ku bëjnë fjalë për...

Z.M.Çakaj: Në pikën 1 pas fjalisë së fundit “në letër dhe formë elektronike” të shtojmë “gjithashtu.. pra pikën 1 ta organizojmë me dy germa germa “a” dhe germa “b” dhe germa “b” të jetë “gjithashtu dërgimi i listës së zgjedhësve dhe të dhënave të tjera të mundësohet dhe në format elektronik dhe t'i dërgohet PEI-it” pra, të jetë i aksesueshëm dhe për PEI-in. E rëndësishme është ta vendosim këtu.

Znj.I.Nano: Singërisht do të doja një mendim IT, sepse i dërgohet KQZ-së. në fund të fundit sistemi është në KQZ...

Z.I.Celibashi: A mundet të jap një mendim dhe ndoshta dikush nga ju mund ta formalizojë si propozim? Duke qenë se ne duam ta identifikojmë qartë këtë moment, ndoshta të shtojmë një nen të veçantë pas nenit 10, le të jetë neni 11 që të themi qartë këtë propozim dhe rinumërojmë nenet e tjera. Titulli i nenit të jetë “Dërgimi i listës sipas PEI-it”. Përcaktojmë detyrimin e KQZ-së, se KQZ-ja do ta dërgojë atë në një farë mënyre, për t'i dërguar listën e zgjedhësve për sistemin PEI, të jetë dispozitë më vehte.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Unë jam shumë dakord personalisht, por të mos harrojmë se çfarë akti jemi duke miratuar. Jemi duke miratuar rregullat, caktimin, njoftimin e vendndodhjes së qv-së, përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore dhe në kuadër të qendrës kemi dhe dërgimin e listës së zgjedhësve për qendrën përkatëse. Unë e kuptoj merakun tuaj zoti Çakaj, por nuk është vendi këtu. Gjithësesi nëse vini me një propozim konkret qoftë dhe me një nen tjetër, por përveç formatit elektronik mund të shtojmë “i përshtatshëm për PEI-in”.

Z.M.Çakaj: Dakord, por problemi qëndron këtu “dërgimi i listës së zgjedhësve” siç e parathamë do të bëhet së pari., mënyra se si është ndërtuar ky akt i është referuar procesit të mëparshëm të menaxhimit dhe administrimit të listës së zgjedhësve dhe të dhënave të tjera nga KQV, në qendrën e votimit. Nga ana tjetër ky proces manual i mëparshëm është zëvendësuar me procesin e identifikimit biometrik, drejt kësaj po shkojmë. Thjesht duhet të kemi një parashikim që njeh dhe procesin, pra është i përshtatshëm dhe me procesin që ne po kryejmë tani.

Znj.I.Nano: Zoti Çakaj, të mos mendojmë se ky akt zgjidh të gjitha hallet që kemi me procesin e identifikimit elektronik. Po ju bëj thirrje dhe njëherë lexoni titullin e aktit dhe objektin e këtij akti. Unë përsëri them që nuk është ky vendi për ta vendosur. Në momentin që kemi thënë edhe elektronikisht mund të shtojmë “i përshtatshëm me PEI-in”, por nuk e dërgon kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore këtë formatin elektronik të përshtatshëm me PEI-in. Kjo është çështje e sistemit dhe e KQZ-së, përshtatshmëria e listës elektronike të votuesve me atë ç’ka do të përdorë PEI, nuk besoj se është e njësisë së vetëqeverisjes vendore.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.M.Çakaj: Pikërisht këtu tek fjalia e parë, “në formë elektronike” edhe propozimi im këtu konsistoi që të mos formulojmë një nen më vehte, por le të jetë “i përshtatshëm me PEI-in”. Zgjidh dhe merakun...

Znj.I.Nano: Të mos i hyjmë procedurave që kanë lidhje me akte të tjera mendoj.

Z.M.Çakaj: Dakord, zgjidhe merakun tonë dhe nesër, pasnesër e kemi..

Znj.H.Vukaj: Ne në fakt nuk po i hyjmë procedurave të detajuara, por thjesht jemi në përputhje me ndryshimet e Kodit Zgjedhor dhe njëkohësisht me iniciativat që kemi marrë deri tani. Pa këtë shtesë do të ishte i paplotë dhe do të dukej sikur ishte një proces i vjetër, pra një mbartje e drafteve të vjetra. Detyrimisht në përshtatje me çfarë iniciativash kemi marrë deri tani, kjo shtesë e propozuar nga zoti Çakaj, mendoj se është shtesa e duhur për t’iu përshtatur të gjithë hapave që kemi marrë deri tani, faleminderit.

Z.D.Çaka: Ne kemi një lidhje bashkëlidhur këtij akti, i cili ka shënimin 1, 2, 3 dhe 4 tek shënimi 4 ka të bëjë pak a shumë me ekstraktin dhe të dhënat e zgjedhësve që thotë “listën përfundimtare”. Në pikën 4 thotë “të dhënat e përmendura më sipër duhet të dërgohen në KQZ në letër dhe në formë elektronike, format excel me këtë adresë”. Mbase nuk ka nevojë të shtohet tek akti brenda dhe në këtë formatin excel nëse biem dakord ta vendosim “në format të përshtatshëm me PEI-in”. Pra, formatin e kemi të përcaktuar tek lidhja që thotë “format excel” mbase këtu, pa pasur nevojë të ndërhyjmë meqenëse është pjesë integrale e këtij udhëzimi.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.H.Vukaj: Jo, është nevoja për ndërhyrje sepse mbase nxitjet, për të respektuar sa më mirë përmbajtjen e një akti normativ ne do t'i marrim nga dispozitat e pastaj nga lidhjet e tyre. Le të jetë e draftuar një pikë, ose një germë në nenin 10 dhe më pas përshtasim dhe aksesorin e saj, faqen excel.

Z.M.Çakaj: Bëjmë një formulim të tillë, së pari ta vendosim këtu dhe së dyti në akt. Në aktet e tjera e kemi dhe bazën ligjore të vendosur. Neni 10, pika 1 në fjalinë e fundit “.në letër dhe në formë elektronike, i cili duhet të jetë i përshtatshëm me PEI-in”. Unë besoj se kaq reflekton proceset që ne po kryejmë dhe së dyti është një bazë ligjore dhe për aktet që ne do të miratojmë nesër, pasnesër lidhur me procesin e administrimit dhe organizimit të identifikimit elektronik.

Z.D.Çaka: Mos ngarkojmë me përgjegjësi kryetarët e njësisë së qeverisjes vendore që të bëjnë një format që mbase...

Z.M.Çakaj: Do ta kenë gati nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rastin konkret ne përcaktojmë normën dhe jemi në rregull. Formatin do të jetë elektronik, do të jetë i përputhshëm, i përshtatshëm me PEI-in. Besoj jemi dakord të gjitha palët.

Znj.I.Nano: Më lejoni të përmbledh propozimet e deri tanishme për nenin 10. Propozimi i parë është propozimi i zotit Çaka për ndryshimin e titullit duke shtuar “të dhënat”. Pra, “Dërgimi i të dhënave të qendrës së votimit dhe listës së zgjedhësve”, ose “Dërgimi i listës së zgjedhësve dhe të dhënave të qendrës së votimit”. Propozimi i zotit Çakaj, në fund të fjalisë së paragrafit 1 të shtohet togfjalëshi “të përshtatshëm me PEI”. Po kjo të shtohet dhe aty ku zoti Çaka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

përmendi pak më herët, tek anekset. Tek shënimi 4 “..në letër dhe në formë elektronike”, pra të heqim formatin excel dhe ta lemë të hapur “të përshtatshëm me PEI”. Këto janë tre propozimet..

Znj.H.Vukaj: Të përshtatshëm për t’u aplikuar në PEI.

Znj.I.Nano: Dakord, të përshtatshëm për t’u aplikuar në PEI. Edhe tek neni 10, edhe tek aneksi të vendoset kjo shprehje, ky togfjalësh. Atëherë votojmë propozimin e parë të zotit Çaka për ndryshimin në titull, duke e riformuluar titullin “Dërgimin e të dhënave të qendrës së votimit dhe listës së zgjedhësve”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet ndryshimi në titull!

Votojmë propozimin e zotit Çakaj për të shtuar togfjalëshin “..në letër dhe formë elektronike të përshtatshëm për t’u aplikuar nga PEI”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Meqenëse arritëm në një formulim, megjithëse nuk është rradha këtu, ta shtojmë dhe tek aneksi ku flitet në formën excel të zëvendësohet “në format të përshtatshëm për t’u aplikuar nga PEI”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Miratohet!

Kalojmë në **nenin 11 Sanksione administrative.**

Edhe sanksionet janë të parashikuara në Kodin Zgjedhor, nuk di nëse keni ndonjë propozim konkret? Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 12 Shfuqizime.

Nëpërmjet hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të ri, shfuqizohet udhëzimi i vjetër.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Neni 13 Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Bëmë dhe një ndryshim tek aneksi dhe tek skema e qendrës së votimit. Besoj jemi të gjithë dakord e diskutuam dhe më herët, e parashikuam edhe në dispozitat e udhëzimit të shtohet vendosja e kamerave në qendrat e votimit në mënyrë që të pamundësohet aksesimi i kamerave në dhomën e fshehtë. Pra të sigurohet fshehtësia e votës. Do të votojmë dhe këtë ndryshim tek skema.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Z.M.Çakaj: Unë kam dhe një propozim tjetër, tek skema e votimit në vijim të ndërhyrjes së zotit Kaso dhe zotit Kazia në të majtë nqs e kemi fletën e votimit, kemi nr.1 “identifikimi elektronik i votuesit”, jam dakord të shtojmë dhe fjalën “nga PEI”, ose “nëpërmjet PEI-it”. Pra “identifikimi elektronik i votuesit nëpërmjet PEI-it”.

Znj.I.Nano: Ka ndonjë mënyrë tjetër përveç se nëpërmjet PEI-it?

Z.M.Çakaj: S'ka po meqenëse po e implementojmë PEI-in e kemi vendosur dhe në akt, besoj se jam në rregull.

Znj.I.Nano: Kolegë? Ok “nga PEI”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!


Meqenëse e votuam në parim, e votuan nen për nen me të gjitha ndryshimet është momenti të votojmë në tërësi aktin.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Miratohet!

Komisioni Rregullator sapo miratoi udhëzimin “Për caktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”.

Udhëzimi nr.1

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

05.12.2020

Ora 11:50

RENDI I DITËS

Projektakti “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilirjan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y.Merkaj**
- **Parti Politike PD, LSI**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Vazhdojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i projektaktit “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”. Do t’i lutesha Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, zotit Ilirjan Celibashi për të prezantuar projektaktin dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

relacionin e përgatitur nga administratae KQZ-së për atë c'ka na e ka diktuar përgatitjen e këtij akti, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Faleminderit, më së pari duhet të them që ky akt vjen në përmbushje të detyrimeve të Kodit Zgjedhor për ta nxjerrë këtë akt. Ky akt është në kompetencë të Komisionit Rregullator për ta miratuar. Opinioni imështë që ky akt përbën një nga aktet më të rëndësishme të aspektit përgatitor zgjedhor edhe pse vetë shpresoj dhe jam i bindur 100% që për këto zgjedhje dobia, ose përdorimi i këtij akti do të jetë i nevojshëm. Akti ka për qëllim të përcaktojë rregullat për emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve dhe KQV-ve në rastin kur partitë politike kanë të drejtën për të propozuar anëtarë të KZAZ-ve dhe të KQV-ve, për arsye të ndryshme objektive të ndryshme ligjore nuk e përmbushin këtë angazhim por dhe të drejtë të tyre. Padyshim që ky është një moment shumë delikat pasi në një lloj mënyre si të thuash synon të ndërhyjë në një proces ku kodi e ka njohur si të drejtë të partive politike. Marrë në konsideratë këtë moment, ne jemi përpjekur që akti të reflektojë të gjitha ato garanci të domosdoshme për organizimin dhe funksionimin e këtyre komisioneve edhe në rastet kur këto komisione në përbërjen e tyre nuk reflektojnë interesin dhe angazhimin e partive politike. Pavarësisht faktit që ata që do të emërohen atynuk vijnë si propozime të partive politike, në mënyrën se si ne i kemi përcaktuar kriteret dhe rregullat për emërimin e tyre, mendojmë që ofrojmë siguri të plotë në lidhje me integritetin e aktivitetin e këtyre komisionerëve. Projektakti, edhe për shkak të rëndësisë që ka është konsultuar edhe me përfaqësues të partive politike. Gjithashtu është konsultuar dhe me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Na janë përgjigjur me komente dhe opinione nga disa përfaqësues të partive politike. Për pjesën më të madhe të këtyre opinioneve dhe mendimeve, ne jemi dakordësuar dhe i kemi reflektuar në akt. Po kështu dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

nga organizatat e shoqërisë civile, kryesisht nga KRIK ne kemi marrë komente, opinione dhe propozime për projektaktin dhe një pjesë të mirë të tyre i kemi reflektuar, kryesisht ato që kanë të bëjnë me karakteristikat dhe dokumentacionin që do të duhet të plotësojnë kandidatët për anëtarë të KZAZ-ve dhe të KQV-ve në rastin kua ata emërohen kryesisht. Mendojmë që reflektuar maksimalisht në komentet e përfaqësuesve të partive politike dhe të organizatave të shoqërisë civile i kanë dhënë këtij akti në pikëpamje të garancive që duhet të ofrojnë për procesin zgjedhor, interesin që kanë partitë politike më së pari, por dhe zgjedhësit për administrimin e procesit zgjedhor nga komisionet e niveleve të dyta e të treta ku anëtarësia e tyre është bërë kryesisht nëpërmjet KQZ-së., faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi për paraqitjen e projektaktit! Faleminderit në fakt dhe administratës së KQZ-së për relacionin shumë të detajuar për këtë projektakt ashtu sikundër ju, por dhe ne shpresojmë që partitë politike dhe subjektet zgjedhore në përgjithësi të ushtrojnë të drejtën e tyre lidhur me paraqitjen propozimeve konkrete për anëtarë dhe sekretarë të KZAZ-ve dhe qendrave të votimit dhe të mos jetë fare i nevojshëm ndërhyrja e këtij akti. Gjithësesi ne si Komision Rregullator dhe ju si Komisioner së bashku me administratën e KQZ-së le të themi nëpërmjet këtij akti i kemi paraprirë çdo situatë të mundshme. Akti që ka formën e një udhëzimi ka 15 nene. Unë i bashkohem atyre që dhe Komisioneri tha lidhur me konsultimin e deritanishëm dhe një falenderim paraprak për përfaqësuesit e partive politike dhe përfaqësuesit e shoqërive civile të cilët e ndjekin me interes veprimtarinë normative të Komisionit Rregullator dhe me përgjegjshmëri të lartë paraqesin propozime konkrete. Unë po çel diskutimin në parim lidhur me projektudhëzimin. Së pari u drejtohem kolegëve anëtarë të Komisionit Rregullator në se kanë diçka për të diskutuar në parim? U

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

drejtohem përfaqësuesve të partive politike parlamentare nëse kanë diçka përveç atyre që na kanë dërguar paraprakisht me e-mail, komente, kanë diçka tjetër për të diskutuar në këtë moment? Në kuadër të diskutimit në parim të projektaktit? Me sa shoh unë nuk ka diskutime në parim. Do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë në parim projektudhëzimin “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”.

Kush është dakord në parim me projektaktin?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet në parim projektudhëzimi.

Fillojmë diskutimin nen për nen.

KREU I


DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe objekti.

Para kësaj kam përshtypjen që zonja Vukaj do të vijojë diskutimin e nisur më herët.

Znj.H.Vukaj: Unë po vijoj me atë ç’ka nisa më herët. Di që grupet e interesit kanë sjellë mendimet e tyre. Ne i kemi shqyrtuar dhe marrë në konsideratë. Për teknikë legislative dhe për të qenë më në përputhje me parimin e ligjshmërisë dhe përputhshmërisë do të konsideroja që nenit 1 t’i shtonim bazën ligjore siç përcakton Kodi Zgjedhor dhe konkretisht nenin 29, pika 5, 6, 7 dhe 8. Kjo do të ishte më e drejtë dhe në të njëjtën kohë do të ishte më e plotë për aplikimin e të gjithë stafit normal.

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Pra para nenit 1 tek baza ligjore “Komisioni Rregullator, në mbështetje të nenit 20, paragrafi 1, shkronja “a”, nenit 29, paragrafi 5, 6, 7 dhe 8, nenit 36 paragrafi 5, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendosi:. Duhet shtuar dhe fjala “vendosi”.

Kush është dakord me propozimin e zonjës Vukaj dhe me propozimin tim për të shtuar fjalën “vendosi”?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet ky ndryshim!

Neni 1. Qëllimi dhe objekti.

Kemi ndonjë propozim konkret, diskutime, shtesa, ndryshime? Përfaqësuesit e partive politike në qoftë se kanë diçka në lidhje me nenin 1? Apo do ta lemë diskutimin si tek akti i kaluar, në qoftë se keni diçka paraprakisht, të mos ju them nen pas neni për propozime, apo shtesa që mund të keni. Do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullator të votonim nenin 1.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet neni 1!

Neni 2. Të drejtat e anëtarit dhe sekretarit të emëruar kryesisht.

Propozim konkret? Nuk ka, e votojmë nenin 2.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Neni 3. Kushtet për emërimin kryesisht të anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së.

Propozim konkret për ndonjë ndryshim? Nuk ka! E kalojmë në votim.

Kush është dakord me nenin 3?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 3!

Neni 4. Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KZAZ-së.

Kemi ndonjë propozim konkret nga anëtarët ose përfaqësuesit e partive politike parlamentare? Kalojmë në votim nenin 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 4!

Neni 5. Njoftimi publik për emërimin kryesisht për përbërjen e KZAZ-ve.

Unë thjesht do të doja t'u tërhiqja vëmendjen administratës dhe Komisionerit le të themi, meqenëse fjalia e parë është "Komisioneri, jo më vonë se 140 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon në media dhe në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, njoftimin për shprehje interesi..". duke llogaritur 140 ditë para zgjedhjeve, ne vlerësojmë që me miratimin sot të këtij akti, duhet menjëherë të bëhet njoftimi për shprehjen e interesit. Pra është çështje e zbatimit të menjëhershëm sa i përket kësaj pike. Për nenin 5 ka dikush ndonjë propozim? Po zoti Çela!

Z.A.Çela: Pika 2, germa b, iii do të propozoja të bëhej "kopje e noterizuar e diplomës së arësimit të lartë".

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Lidhet me dokumentacionin që duhet të paraqesin shtetasit.

Z.A.Çela: Është vetëm kopje, por të shtohet e noterizuar.

Znj.I.Nano: Të bëhet kopje e noterizuar, të jetë dhe për sekretarin. Në se ne do ta votojmë pro këtë propozimin tuaj, besoj se do të jetë dhe tek nenet e rradhës.. do të jemi në të njëjtën situatë?


Z.A.Çela: I shohim në vazhdim.

Znj.I.Nano: Kemi ndonjë propozim tjetër në lidhje me nenin 5? E votojmë nenin 5? Po zoti Celibashi?

Z.I.Celibashi: Më falni se po ju ndërpres në moment votimi. Ideja është për të lehtësuar pak çështjen e aplikimit dhe dokumentacionit. Në momentin e parë e kemi konsideruar që ndoshta nuk do të ishte e domosdoshme për të gjithë aplikantët që të kishin detyrime financiare për të paguar noterin e etj., por në momentin që ai bëhet komisioner, në atë moment dokumentacioni duhet të jetë në përputhje me të gjitha normat. Gjithësesi si ta çmoni ju, nuk e di sa i qartë isha.

Znj.I.Nano: Pra, ju thoni që në momentin e aplikimit të jetë vetëm një kopje e diplomës dhe në rast përzgjedhjeje të plotësohet dokumentacioni konform rregullave.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.I.Celibashi: Do të ngarkojë shumë procesin, do të jetë me kosto, shpenzime do t'i demotivojë të interesuarit.

Znj.I.Nano: Ne do ta votojmë propozimin e zotit Çela. Unë në pikën e mëpasme ku pjesë e dokumentacionit që do të paraqesin shtetasit “deklarim të nënshkruar nga shtetasi sipas lidhjes 1”, pra lidhet dhe me lidhjen 1. “Tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike”. Një nga deklarimet që bën dhe mban përgjegjësi shtetasi që aplikon “nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor”. Mendoj që duhet të vendosim një afat dhe këtu. Nuk mund të themi historikisht gjithë jetën nuk ka pasë një aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore. Kur ne vendosim kushtin “vetëm tre vjet të mos ketë qënë pjesë e strukturave drejtuese të një partie politike”. Pra, ky është një kufizim i një niveli më të lartë të mos ketë qënë pjesë e strukturave drejtuese të një partie politike dhe sot të mos jetë kandidat për anëtar apo sekretar të KZAZ-së, apo KQV-së. Mendoni për aktivitetin e deklaruar publik, apo aktivitet politik të një subjekti zgjedhor, çfarë afati duhet të vendosim? Unë mendoj që duhet të vendosim një afat. Nuk e di në diskutimet paraprake lidhur me këtë akt edhe zoti Çaka dhe zoti Çakaj kishin një vlerësim të tyre. Zoti Çaka ju lutem nuk dëgjoheni.

Z.D.Çaka: Jam dakord në rradhë të parë me propozimin tuaj, sepse duhet të vendoset një afat. Nuk mundet në mënyrë të pafundme të vendosim një kufizim të tillë. Unë mendoj të bëjmë një unifikim të të dy afateve, edhe në rastin e strukturave drejtuese në një parti politike dhe propozoj afatin tre vjeçar.

Znj.I.Nano: Po zoti Çakaj, keni fjalën!


*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.M.Çakaj: Atëherë, lidhur me normën e parashikuar neni 5 pika 2, germa b, 4 (iiii), unë propozoj që të ndahen këto dy pika nga njëra tjetra se norma tre vitet e fundit nuk ka qenë pjesë e strukturave asnjëherë e partive politike sigurisht është një ndalesë dhe patjetër që një kandidaturë për anëtarë apo sekretar KZAZ-je, apo KQV emëruar kryesisht, në mendimin tim sigurisht që nuk duhet të jetë i përfshirë në asnjë nivel drejtues të partive politike, minimumi është tre. Ndërsa pika më poshtë për aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor, unë propozoj që të paktën të kemi një mandat 4-vjeçar që ta deklarojë. Në rastin konkret të mos jetë 3, por të paktën 5 vjet. Pra, meqenëse zgjedhjet do të zhvillohen në vitin 2021 të jetë të paktën, të mos ketë qenë i deklaruar me aktivitet publik politik, apo i përfshirë në një aktivitet politik të një subjekti zgjedhor që nga zgjedhjet e 2017 e në vijim. Në rastin konkret afati i ndalimit të jetë 5 vjeçar. Në lidhje me propozimin e zotit Çela ku parashikon që tek lista e dokumentacionit kërkon kopje të noterizuar të diplomës së arësimit të lartë, pavarësisht se nuk kemi kaluar tek neni 6 që vijon më pas. Pika 2 e nenit 6 thotë “Objekti i verifikimit nga administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është verifikimi i dokumentacionit të paraqitur sipas parashikimeve të nenit 5, paragrafi 2 të këtij udhëzimi si edhe plotësimi i kushteve të përcaktuara në nenin 3 dhe 4 të këtij udhëzimi”. Në qoftë se administrata e KQZ-së ka mundësi të verifikojë kopje të panoterizuara dakord, por unë i bashkohem propozimit të zotit Çela. Administrata e KQZ-së e ka shumë më të lehtë të verifikojë kopjen e noterizuar të diplomës. Në nenin 5, pika 2 germa b, iii në propozimin konkret do të sugjeroja për “nuk ka patur aktivitet, jo më pak se 5 vjet...”.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Zoti Çakaj i bashkohem propozimit tuaj. Nuk e di nëse zoti Çaka tërhiqet nga propozimi i tij për tre vjet?

Z.D.Çaka: Dakord! Edhe pesë vjeçari është i pranueshëm. Qëllimi është që të kemi një afat në kufizimin kohor.

Znj.I.Nano: E qartë, atëherë unë do të thoja 5 vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor. Atëherë kemi dy propozime për nenin 5. Propozimi i parë është propozimi i zotit Çela për kopjen e noterizuar të arsimit të lartë, ose të arsimit juridik kur bëhet fjalë për sekretarin. Votojmë propozimin e zotit Çela.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet propozimi i zotit Çela!

Kalojmë tek propozimi i zotit Çaka dhe zotit Çakaj që u harmonizuan në një. Tek deklarimi i nënshkruar i shtetasit sipas Lidhjes 1. Të shtohet pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor.

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Ndoshta këtë ndryshim do të duhet ta pasqyrojmë edhe tek lidhjet që i bashkëlidhen, kryesisht tek lidhja 1.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU**



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Kalojmë te Neni 6. Miratimi i listës së shtetasve që mund të emërohen kryesisht në përbërje të KZAZ-së.

Ka ndonjë propozim konkret? S'ka! Ta votojmë nenin 6 siç e ka sjellë administra në Komisionin Rregullator?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 6!

Neni 7 Përzgjedhja e shtetasve për plotësim të vakancave në KZAZ.

Është një procedurë e tërë që ndiqet nga ana e KQZ-së. Kemi ndonjë propozim konkret për këtë nen, ndonjë shtesë apo ndryshim? E votojmë nenin 7?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 7!

Neni 8. Kushtet për emërimin kryesisht anëtar dhe sekretar i KQV-së.

Le të themi vijmë tek të njëjtat kritere deklarime, dokumenacion dhe procedurë për plotësimin e vakancave në KQV-të.

Kemi ndonjë propozim? E votojmë nenin 8?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 8!

Neni 9. Papajtueshmëritë me detyrën e anëtarit dhe të sekretarit të KQV-së.

Ka ndonjë propozim konkret? Nuk keni! E votojmë nenin 9?

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 9!

Neni 10 Njoftimi publik për emërim kryesisht anëtar dhe sekretar i KQV-së.

Po zoti Çaka!

Z.D.Çaka: Mendoj se duhet të reflektohen ndryshimet që u bënë tek neni për emërimin kryesisht të anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së, tek aktiviteti i deklaruar publik, pra të bëhet kufizimi i pesë vjeçarit.

Znj.I.Nano: Atëherë, duke qenë se këtu jemi tek dokumentacioni, le të ruajmë të njejtin standart sikundër vendosëm më herët. Ndërkohë mendoj se duhet të rishohim në këndvështrimin e këtyre ndryshimeve që miratuam edhe një pikë qoftë në nenin 5, qoftë në nenin 10. Pra, qoftë në rastin e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, por qoftë dhe në rastin e anëtarëve dhe sekretarëve të KQV-ve. Tek deklarimi i nënshkruar i shtetasit dhe këtu jemi tek Lidhja 2 tek KQV, ndërsa tek KZAZ-ja kemi Lidhjen 1. Është dhe deklarimi që shtetasi është mbajtës i diplomës sipas kopjes së paraqitur. Në momentin që ne votuam që ai të sjellë një kopje të noterizuar të diplomës, mendoj që nuk ka vend që të deklarojë që është titullar i diplomës. Nëse do ta votojmë në nenin 10 këtë ndryshim do ta pasqyrojmë dhe në nenin 5 në të njejtin moment që kërkohej të bëhej ky lloj deklarimi.

Znj.H.Vukaj: Deklarata nuk është se nuk ka përputhshmëri me garancinë për hir të sigurisë të atij dokumenti. Nuk mendoj se po ta hiqnim apo po ta vinim do të bënte ndonjë ndryshim papërputhshmërie. Që të rritet përgjegjësia për dokumentin që sjell. Ne e dimë shumë mirë realitetin se ç'ka ndodhur në këto vite me diplomat,

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

apo me veprime të tjera për njehsimin e akteve, kështu që deklarata le të rri për të rritur shkallën e sigurisë, faleminderit!

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Thjesht do të dua ta argumentoj propozimin tim pastaj është çështje e vlerësimit të Komisionit Rregullator. Në rastin e një kopje të diplome të panoterizuar, deklarata që ai është titullari i asaj diplome e ngarkon me përgjegjësi vetë shtetasin. Pastaj është çështje e KQZ-së që kryen verifikimin. Në rastin e një diplome të noterizuar, sigurisht që ky është një dokument që ka një vlerë të ndryshme në raport me një kopje. Do të duhej një proces më i thelluar verifikimi nga ana e KQZ-së. Për këtë arsye vlerësova që në nenin 5 dhe në nenin 10 të mos jetë pjesë e deklaratës edhe ky lloj deklarimi që është titullar i diplomës, sepse në fakt këtë e ka bërë noteri nëpërmjet noterizimit të kopjes së diplomës. Në çdo rast e vlerësojnë dhe kolegët.

Znj.H.Vukaj: Dakord, por jep një lloj sigurie për të rritur sensibilitetin e palëve që me këtë lloj dokumenti nuk luhet. Dakord jam edhe me ju.

Z.M.Çakaj: Edhe unë ndaj të njejtën konsideratë si zonja Vukaj, por sigurisht që është një garanci më shumë për palët, por në momentin që ne kemi vendosur standartin e paraqitjes së kopjes së noterizuar të diplomës, besoj se garancia arrihet me paraqitjen e këtij dokumenti. Kështu që edhe unë jam dakord ta heqim, sepse qëllimi i verifikimit arrihet nëpërmjet paraqitjes së dokumentit. Të gjithë e dimë që institucioni i noterit publik është institucion i ngarkuar nga ligji që verifikon njësi me origjinalin të dokumentit të paraqitur. Në rastin konkret e merr përgjegjësinë e paraqitjes së dokumentit, sigurisht aplikanti, por dhe noteri që ka bërë noterizimin përkatës.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Znj.I.Nano: Atëherë, më lejoni të bëj një përmbledhje të propozimeve për nenin 10. Në nenin 10 shtohet pesë vjeçari për aktivitet të deklaruar publik për fushatë zgjedhore ose në aktivitetin publik të një subjekti zgjedhor. Hiqet parashikimi është titullar i diplomës sipas kopjes së paraqitur dhe shtohet tek pika 3 fotokopje e diplomës së noterizuar.

Votojmë nenin 10 me të gjitha ndryshimet e ngjashme me ato që u bënë tek neni 5.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka


Miratohen ndryshimet!

Më lejoni t'u them që këto ndryshime që sapo bëmë diktojnë një ndryshim tjetër në nenin 7. Ndjesë, por duhet t'i kthehemi nenit 7. Koncepti i aktit të ndërtuar nga administrata e KQZ-së lidhej me paraqitjen fillimisht të kopjes së panoterizuar dhe më pas ajo që Komisioneri tha më herët që kur emërohet anëtari, apo sekretari i KZAZ-së dorëzon një kopje të noterizuar të diplomës së arsimit të lartë. Në momentin që ne e kërkojmë këtë që në aplikim, mendoj që duhet të hiqet pika 4 e nenit 7.

Znj.H.Vukaj: Mund ta lexoni të lutem për transparencë të palëve që po na ndjekin.

Znj.I.Nano: Atëherë, pika 4 e nenit 7, pasi përfundon procedura e përzgjedhjes së shtetasve për plotësimin e vakancave në KZAZ parashikon “shtetasi i emëruar kryesisht anëtar, apo sekretar i KZAZ-së, dorëzon në KQZ kopje të noterizuar të diplomës së arsimit të lartë”. Pra e ka dorëzuar tashmë që në momentin e aplikimit.

***Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Votojmë që të heqim pikën 4 të nenit 7.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Kalojmë në **nenin 11 Miratimi i listës së shtetasve që mund të emërohen kryesisht në përbërje të KQV-së.**

Nëse keni ndonjë propozim konkret? Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 11!

Neni 12. Përzgjedhja e shtetasve për plotësim të vakancave në KQV.

Këtu duhet të reflektohet heqja e pikës 4. Propozimi im është që të hiqet pika 4 e nenit 11.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet neni 12!

Neni 13. Trajnimi i shtestave të cilët emërohen kryesisht anëtar apo sekretar të KZAZ/KQV-ve.

Ka ndonjë propozim për ndonjë shtesë, apo ndryshim? Kalojmë në votim të nenit 13.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Miratohet neni 13!

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

Neni 14 Shfuqizime.

Nëpërmjet miratimit të këtij udhëzimi, shfuqizohet një udhëzim më i hershëm i KQZ-së i vitit 2013.

Kush është dakord?

***Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)*

***Kundër:** S'ka*

Miratohet!

Neni 15. Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

***Pro:** 5 (znj.Nano, z. Çela, z. Çaka, znj. Vukaj, z. Çakaj)*

***Kundër:** S'ka*

Miratohet!

Kalojmë tek lidhjet bashkëlidhur.

Lidhja 1, është një deklaratë.

Z.A.Kaziu, përfaqësues i Lëvizjes Socialiste për Integrim: Tek Lidhja 1. Tek pika 6 “jam titullar i diplomës, sipas kopjes së paraqitur”, duhet të themi kopjes së noterizuar.

Znj.I.Nano: Këtë thamë që do ta heqim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

Z.D.Çaka: Të shtohet tek pika 2 afati pesë vjeçar për aktivitetin e deklaruar publik në fushatë politike.

Znj.I.Nano: Për pesë vitet e fundit. Atëherë për shtesën “për pesë vitet e fundit” tek pika 2 dhe heqjen e pikës 6.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Lidhja 2. Në këtë rast është për anëtar dhe sekretar të KQV-ve, besoj dhe këtu duhet shtuar në pikën 2 “për pesë vitet e fundit” dhe të hiqet pika 6.

Votojmë Lidhjen 2 me këto dy ndryshime.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Atëherë kemi miratuar në parim projektudhëzimin “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”, e votuam dhe miratuam nen për nen me të gjitha ndryshimet është momenti të votojmë në tërësi projektudhëzimin.

Kush është dakord?


Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Miratohet!

Komisioni Rregullator sapo miratoi udhëzimin “Për caktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.05.12.2020*

plotësimin e vakancës së KZAZ-së dhe KQV-ve”. Ftojmë në këtë rast Komisionerin dhe administratën e KQZ-së që ky akt hyn sot në fuqi dhe të bëjnë shpalljen për shprehjen e interesit për shtetasit që duan të aplikojnë për këto pozicione.

Udhëzimi nr.2

*Zbardhi materialin e inçizuar
Merita DULAKU*

